



MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

**NDËRMJET
PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA MBI VENDBANIMET NJERËZORE**

**DHE
PAX**

**DHE
KOMUNËS SE VUSHTRRIË**

PREAMBULA:

DERISA, Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (më tej në tekst "UN-Habitat"), i krijuar me anë të Rezolutës 32/162 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 19 dhjetor 1977, i transformuar në Program me anë të Rezolutës së saj 56/206 të datës 21 dhjetor 2001, me seli në Najrobi, Keni, është agjencia bashkërenduese në kuadër të Sistemit të Kombeve të Bashkuara për vendbanimet njerëzore dhe është pikë kontakti për monitorimin, vlerësimin dhe zbatimin e Agjendës së Habitatit, si dhe menaxher për detyrat rreth kapitullit për vendbanimet njerëzore të Agjendës 21. Në bashkëpunim me qeveritë, UN-Habitat-i është përgjegjës për promovimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me të gjithë partnerët, duke i përfshirë autoritetet lokale dhe organizatat private dhe joqeveritare për zbatimin e Agjendës së Habitatit dhe Post-2015 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ-të) në veçanti, Objektivi 11 i "Bërjes së qyteteve qyteteve dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, reziliente dhe të qëndrueshme";

DUKE PASUR PARASYSH që PAX është organizatë lidere e paqes në Holandë (këtej e tutje "PAX"). Për më shumë se 60 vite, PAX ka punuar me qytetarë dhe partnerë të angazhuar në mbrojtjen e civilëve nga veprimet e luftës, dhënien fund të dhunës së armatosur, si dhe në ndërtimin e paqes. PAX operon e pavarur nga interesat politike dhe përkrahet nga një grup i gjerë i qytetarëve, organizatave sociale dhe kishave të përfshira, përfshirë Kishën Katolike Romake dhe Kishën Protestante në Holandë. PAX punon në bazë të dy vlerave kryesore të paqes në zonat në konfliktit: dinjitetin njerëzor dhe solidaritetin me aktivistët e paqes dhe viktimat e dhunës në luftë. Në Kosovë, PAX punon në bashkëpunim të ngushtë me Community Building Mitrovica (CBM) dhe ka angazhim afatgjatë për rritjen e dialogut ndërmjet komuniteteve në veri.

DUKE PASUR PARASYSH që komuna e Vushtrrisë, Kosovë*¹, e përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, (këtej e tutje "Komuna e Vushtrrisë"), zotohet të ndërmarrë veprime që qojnë në zhvillim dhe menaxhim hapësinor dhe urban të përmirësuar dhe të ndjeshëm ndaj mjedisit, ri-organizimin dhe fuqizimin e strukturave organizative që janë adekuate për planifikimin strategjik dhe pjesëmarrës, si dhe në zbatimin e planit, përmirësimin e dialogut publik, përgjegjshmërinë,

¹ Kosova*: "Ky përcaktim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në harmoni me RKSKB 1244/99 dhe opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës."

llogaridhënie dhe bashkëpunimin ndër-komunal në përkrahje të kushteve të përmirësuara të jetesës dhe zhvillimit gjithëpërfshirës;

DERISA, komuna e Vushtrrisë, UN-Habitat-i dhe PAX-i kanë rënë dakord për të bashkëpunuar në zbatimin e projektit “Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës” financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida);

DERISA, projekti “Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës” me fondet e siguruar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida), është përpiluar nën diskrecionin e vet për të bashkëfinancuar në komunat partnere zbatimin e një numri të kufizuar të projekteve të investimeve kapitale dhe/ose shërbimeve ndër-komunale që rezultojnë nga procesi i planifikimit dhe studimet që ndërliken me planifikimin. Kushtet e bashkëfinancimit të këtyre projekteve dhe shërbimeve do të rregullohen përmes marrëveshjeve të veçanta;

DERISA, UN-Habitat-i dhe komuna e Vushtrrisë (më tej në tekst të referuara si “Palët” dhe individualisht si “Pala”) duke njohur përfitimet e bashkëpunimit të mirëfilltë, dhe të cilët dëshirojnë për të realizuar një bashkëpunim të tillë, kanë hyrë në këtë Memorandum të Mirëkuptimit (këtu e tutje referuar si “MM”) në frymën e besimit dhe bashkëpunimit;

PRANDAJ, palët bien dakord si më poshtë

NENI I **Qëllimi**

1. Ky MM ka për qëllim ofrimin e një kornize të bashkëpunimit në kuadër të së cilës UN-Habitat-i, PAX dhe Komuna e Vushtrrisë do të zbatojnë së bashku projektin “Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës”.
2. Bashkëpunimi i palëve në Vushtrrisë, Kosovë, do të zbatohet me një fokus në nxitjen e zhvillimit gjithëpërfshirës dhe qeverisjen e mirë nëpërmjet zhvillimit të planifikuar dhe të ndjeshëm ndaj konfliktit, me komunitete të integruara në të gjitha fazat e planifikimit dhe zbatimit dhe në kuadër të bashkëpunimit efikas ndër-komunal dhe qeverisjes në shumë nivele.
3. Në bazë të nenit II, klauzola (5) më poshtë dhe rregulloreve, rregullave, politikave, praktikave dhe procedurave të tyre përkatëse, Palët bashkëpunojnë dhe punojnë së bashku për zbatimin e aktiviteteve në përkrahje të planifikimit strategjik dhe dialogut publik që do t’i kontibudojnë integritet dhe proceseve të reformimit të administratës publike.
4. Pjesa në vijim paraqet rezultatet primare të bashkëpunimit në Komunën e Vushtrrisë, Kosovë.
 - (a) Rritja e kapacitetit institucional të komunave të Kosovës, ku institucionet komunale janë fuqizuar për të përmirësuar në mënyrë progresive performancën e përgjegjësive të tyre në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e integruar hapësinor dhe urban, të harmonizuar me kërkesat ligjore të Kosovës dhe parimet e administrimit të mirë, si dhe në interes të integritet territorial;
 - (b) Rritja e cilësisë së qeverisjes lokale përmes dialogut të gjerë publik, mekanizmave për kthim të përgjigjeve/informatës kthyesë dhe llogaridhënie, si dhe veprimeve të shoqërisë civile që për afrojnë qytetarët nëpër komunitetet e ndara për të siguruar efektivitetin, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e veprimeve që forcojnë kontratën shoqërore;

- (c) Mekanizmat për dialogun ndër-komunal dhe atë qendror-lokal, koordinimi dhe bashkëpunimi janë përmirësuar ndjeshëm si dhe marrëveshjet ad-hoc të bashkëpunimit ndër-komunal janë duke i kontribuar përmirësimit të standardit jetësor.

NENI II

Përgjegjësitë e përgjithshme të Palëve

1. Palët pajtohen që t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre përkatëse në pajtim më dispozitat e këtij MM. Palët bien dakord të bashkojnë përpjekjet dhe për të ruajtur marrëdhënie të ngushta pune me qëllim të arritjes së objektivave të këtij MM.
2. Palët do ta informojnë njëra-tjetrën për të gjitha aktivitetet e rëndësishme që kanë të bëjnë me këtë MM dhe do të kenë konsultime sa herë që ndonjëra Palë e konsideron këtë të nevojshme.
3. Palët do të përmbahen nga çdo veprim që mund të ketë ndikim negativ në interesat e Palës tjetër dhe do t'i përmbushin zotimet e tyre duke i respektuar plotësisht kushtet dhe afatet e këtij MM dhe parimet e Kombeve të Bashkuara dhe të UN-Habitat-it.
4. Secila palë do të emërojë një pikë kontakti për këtë bashkëpunim siç thuhet në Nenin XI ("Njoftimet"), klauzola (1) këtu e më poshtë.
5. Palët pajtohen se ky MM dhe çdo plan i punës i miratuar tash e tutje në bazë të tij nuk janë dokumente me obligime fiskale apo për financim. Çdo zotim për të transferuar diçka me vlerë e që përfshin rimbursimin apo ofrimin e fondeve, mallrave ose shërbimeve nga ana e Palëve për ndonjë prej aktiviteteve të miratuara do të përcaktohen në marrëveshje të veçanta të cilat duhet të bëhen me shkrim nga përfaqësuesit e Palëve dhe të cilat do të jenë të autorizuara në mënyrë të pavarur nga autoriteti i duhur i palës financuese në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe praktikën e Palëve. Palët pajtohen që ky MM nuk e ofron këtë autorizim.

NENI III

Fushat e bashkëpunimit në mes të palëve

1. Në bazë të Nenit II, pika (5) më lartë, palët do të bashkëpunojnë në zbatimin e projektit 'Programi për Zhvillim Gjithëpërfshirës', përfshirë:
 - (a) Avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm të komunave partnere nëpërmjet proceseve strategjike, gjithëpërfshirëse dhe përfshirëse të planifikimit dhe vendimmarrje të bazuar në informata, krahas projekteve për investime kapitale;
 - (b) Fuqizimin e kontratës shoqërore përmes rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së pushtetit lokal nëpërmjet mobilizimit të shoqërisë civile dhe dialogut publik;
 - (c) Përkrahjen e bashkëpunimit ndër-komunal dhe lokal-qendror për planifikim konsistent dhe ofrim të përmirësuar të shërbimeve tek qytetarët;
 - (d) Fuqizimin e kapaciteteve të komunave dhe organizatave të shoqërisë civile në planifikimin dhe menaxhimin hapësinor dhe territorial dhe çështjet e qeverisjes lokale;

NENI IV

Përgjegjësitë specifike të palëve

1. Në bazë të Nenit II, pika (5) më lartë, përgjegjësitë specifike të UN-Habitat-it janë si më poshtë:
 - (a) Ofron udhëzime, koordinim dhe përkrahje në tërë projektin dhe të lehtësoj ndërlidhjen dhe bashkëpunimin komunë-qendër;
 - (b) Ofron ndihmë profesionale në vendin e punës për një sërë çështjesh të planifikimit me qëllim që të jenë në përputhje, por pa u kufizuar në, me Ligjin për Planifikim Hapësinor, respektivisht vlerësimin e Planit Zhvillimor Komunal, krijimin e bazës së të dhënave hapësinore (niveli lokal); hartimin e Hartës Zonale të Komunës;
 - (c) Ofron trajnime dhe aktiviteteve tjera për ngritjen e kapaciteteve që ndërlidhen me çështjet e planifikimit;
 - (d) Krijon dhe bën të qasshëm Instrumentin për Investime Kapitale në mbështetje të bashkëfinancimit të një numri të kufizuar të projekteve të investimeve kapitale dhe/ose shërbimeve ndërkomunale që rrjedhin nga procesi i planifikimit dhe studimet që ndërlidhen me planifikimin në komunat partnere. UN-Habitat zotohet për zhvillimin e një procesi objektiv dhe transparent të përzgjedhjes së projekteve, duke nënkuptuar se ky Memorandum nuk i jep të drejtën për një minimum të bashkëfinancimit asnjëherë prej komunave partnere dhe se vendimet e bashkëfinancimit të UN-Habitat-it nuk mund të kundërshtohen ligjërisht nga cilado Palë në këtë Memorandum;
 - (e) Përkrahë ndërveprimin dhe shkëmbimin e përvojave mbi praktikën e qëndrueshme zhvillimore, përfshirë çështjet e ndryshimeve klimatike, mobilitetit urban, trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe çështjet tjera të ndërlidhura në mënyrë që të harmonizohet zhvillimi lokal me strategjitë dhe politikën kombëtare;
 - (f) Lehtëson ofrimin e pajisjeve kompjuterike për personelin e UN-Habitat-it të vendosur në objektet e komunës, nëse kërkohet;
 - (g) Aktivitetet do të zbatohen në bashkëpunim me personelin e caktuar komunal. Ekipi i UN-Habitat do të bashkëpunojë ngushtë me kryetarin e komunës, kuvendin komunal, komitetet dhe drejtoritë gjegjëse dhe personelin e caktuar komunal në krijimin dhe përkrahjen e Ekipit Komunal për Planifikim si mekanizëm për arritjen e rezultateve të theksuara më lartë. Aktivitetet e UN-Habitat-it do të realizohen nga personeli i kualifikuar dhe konsulentët e UN-Habitat-it. Emrat e anëtarëve të personelit të caktuar komunal dhe ekipit përkrahës të UN-Habitat-it do të përfshihen në shtojcën A të këtij MM.
2. Në bazë të Nenit II, pika (5) më lartë, përgjegjësitë e veçanta të PAX janë si në vijim:
 - (a) Mbështet shoqërinë civile në monitorimin e performancës së politikave dhe aktiviteteve komunale, nxit kapacitetet e shoqërisë civile për përfshirje në hulumtime dhe analiza të politikave;
 - (b) Mbështet dhe përkrah personelin përkatës komunal në hartimin dhe operacionalizimin e planit për Pjesëmarrje të Qytetarëve për të konsoliduar në mënyrë progresive pjesëmarrjen dhe konsultimin e qytetarëve në formulimin, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave, duke filluar me Hartën Zonale të Komunës;
 - (c) Mbështet zyrtarët përkatës komunal për të hartuar dhe zbatuar masa specifike për pjesëmarrje të qytetarëve dhe llogaridhënie, për të nxitur dialogun dhe bashkëpunimin e qeverisë lokale me shoqërinë civile dhe qytetarët;

- (d) Stimulon veprimtarinë efektive dhe inovative të shoqërisë civile në veri të Kosovës nëpërmes krijimit dhe aktivizimit të një fondi katalitik për shoqërinë civile, të qasshëm nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në komunat partnere me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve dhe llogaridhënies së qeverisjes lokale;
 - (e) Zbaton aktivitetet në bashkëpunim me CBM dhe organizatat tjera të shoqërisë civile në veri të Kosovës, sidomos ato të organizuara nën patronazhin e Ekipit Monitorues për Regjionin e Mitrovicës (MRMT).
3. Në bazë të Nenit II, pika (5) më lartë, përgjegjësitë e veçanta të komunës së Vushtrrisë janë si në vijim:
- (a) Bashkëpunon me personelin e UN-Habitat-it në (ri-) themelimin e Ekipit Komunal për Planifikim (EKP) që siguron koordinimin dhe udhëzimet për punët e tij. Lista e personelit komunal të caktuar është bashkëngjitur në këtë MM si shtojca A;
 - (b) Mban funksional grupin drejtues të kryesuar nga kryetari i komunës së Vushtrrisë për të udhëzuar bashkëpunimin me UN-Habitat-in dhe PAX dhe zbatimin e aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta;
 - (c) Bashkëpunon me ekipin e UN-Habitat-it dhe PAX për zhvillimin e planeve të projektit për fushat e identifikuar të bashkëpunimit, duke përfshirë fazën e tyre të planifikimit dhe implementimit, buxhetimin dhe monitorimin;
 - (d) Krijon, në konsultim me UN-Habitat-in dhe PAX, mekanizma për bashkëpunim me palët e interesit, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, si një element i planifikimit me pjesëmarrje dhe proceset për zbatimin e projektit. Ofron përkrahje materiale ose para për aktivitetet e tilla si takimet dhe debatet që janë pjesë e procesit të konsultimit;
 - (e) Lehtëson komunikimin ndërmjet ekipit të UN-Habitat-it dhe PAX dhe të gjitha organeve dhe drejtorive përkatëse komunale, përfshirë zyrën e kryetarit të komunës dhe siguron qasjes në të gjithë dokumentacionin përkatës;
 - (f) Identifikon mundësitë për bashkëpunim ndër-komunal dhe ndërkufitar;
 - (g) Siguron bashkëfinancim për projektet e propozuara të investimeve kapitale dhe/ose shërbimet ndërkomunale që rrjedhin nga procesi i planifikimit dhe studimet e ndërlidhura me planifikimin të dorëzuara në Instrumentin për Investime Kapitale;
 - (h) Ndan kohën e duhur dhe rimbursos kostot e udhëtimit për personelin komunal që marrin pjesë në takimet apo punëtoritë e përzgjedhura që mbahen jashtë komunës;
 - (i) Ofron hapësirën e nevojshme të punës (zyre), shërbimet dhe pajisjet e nevojshme për personelin e UN-Habitat-it për ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare, me kushte të duhura të punës, si dhe ofron qasjes në hapësira (lokale) për takimet që mbahen si pjesë e realizimit të aktiviteteve sipas planeve të projektit, përfshirë ato për të cilat nevojitet pjesëmarrja e palëve të interesit dhe shoqërisë civile;
 - (j) Komuna zotohet për qasje pjesëmarrëse në planifikim dhe zhvillim lokal si normë e qeverisjes së mirë dhe për të demonstruar transparencë dhe përgjegjshmëri ndaj kontributit të shoqërisë civile dhe qytetarëve dhe angazhim kurdo që është e mundur.

NENI V **Monitorimi dhe Vlerësimi**

1. Palët do të zhvillojnë konsultime të rregullta të ngushta për ta monitoruar dhe rishikuar progresin e aktiviteteve për secilin projekt të përbashkët për të cilat është arritur pajtimi.

2. Palët mund i ndajnë me njëra-tjetrën të gjitha informatat dhe dokumentet përkatëse, përfshirë edhe hulumtimet, raportet dhe çdo informacion tjetër që ka të bëjë me aktivitetet, rezultatet dhe në fund ndikimin e këtij bashkëpunimi.
3. Palët sa herë që është e mundur dhe sipas nevojës, të mund të realizojnë misione të përbashkëta në lidhje me këtë Projekt.
4. Palët do ta informojnë në tërësi Koordinatorin e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë lidhur me veprimet e ndërmarra nga to gjatë përbushjes së këtij MM. UN-Habitat-i do t'i shfrytëzojë kapacitetet e Krye-këshilltares Teknike me seli në Kosovë, sipas nevojës për zbatimin efektiv të këtij Projekti.

NENI VI

Ndërprerja

1. Ky MM mund të ndërpritet nga cilado Palë duke i dhënë palës tjetër një njoftim me shkrim prej tridhjetë (30) ditë para kohës së synuar për të përfunduar. Në rastin e ndërprerjes, Palët duhet t'i ndërmarrin hapat e duhur që aktivitetet në bazë të këtij MM të përmyllen shpejtë dhe në mënyrë të rregullt.
2. Përfundimi i këtij MM nuk do të cenojë asnjë marrëveshje tjetër e cila tashmë ka hyrë në fuqi nga cilado palë.

NENI VII

Ndryshimet

1. Ky MM mund të modifikohet me pajtimin e ndërsjellë me shkrim nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve. Çdo çështje e rëndësishme për të cilën nuk ka ndonjë dispozitë të caktuar në këtë MM do të zgjidhet nga Palët duke marrë parasysh objektivat e përgjithshme të këtij MM dhe në mënyrën që mundëson vazhdimin e raporteve të mira.

NENI VIII

Zgjidhja e kontesteve

1. Çdo kontest që del ndërmjet UN-Habitat dhe Komunës së Vushtrrisë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij MM, përveç kontestit që është subjekt i Nenit 30 të Konventës, ose ndonjë marrëveshje tjetër në fuqi, që nuk zgjidhet me anë të negociatave ose ndonjë formë tjetër të dakorduar të zgjidhjes do të paraqitet, me kërkesë të cilësdo Palë për marrjen e vendimit përfundimtar në një gjykatë prej tre arbitrash, një të emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, një të emëruar nga Komuna e Vushtrrisë dhe i treti, i cili do të jetë kryetari, që do të zgjidhet nga dy të parët.
2. Nëse ndonjëra palë nuk arrin të caktojë një arbitër brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e emërimit nga pala tjetër, ose në qoftë se këta të dy nuk arrijnë të bien dakord mbi arbitrin e tretë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga emërimi i tyre, Presidenti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë do të bëjë emërimet e nevojshme me kërkesë të secilës Palë.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga palët, Gjykata miraton rregullat e veta të procedurës, siguron rimbursimin e anëtarëve të saj dhe shpërndan shpenzimet ndërmjet Palëve, dhe merr të gjitha vendimet me shumicën prej dy të tretave. Vendimi i saj për të gjitha çështjet e procedurës dhe përmbajtjes do të jetë përfundimtar dhe, edhe në qoftë se merret në mungesë të njëjës nga palët, të jetë detyrues për të dyja palët.

NENI IX

Privilegjet dhe imunitetet

1. Asgjë në këtë MM ose në lidhje me të nuk konsiderohet si heqje dorë, qoftë shprehimisht ose e nënkuptuar, nga privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara, përfshirë edhe UN-Habitat-in.

NENI X

Shfytëzimi i emrit, emblemës ose mediave

1. Asnjëra Palë nuk duhet ta shfrytëzojë emrin ose emblemën e Palës tjetër, apo të shkurtesave të tij, në lidhje me punën e saj apo diçka tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar i Palës për cilindo rast.

2. Asnjëra Palë nuk e ka autoritetin, qoftë shprehimisht ose të nënkuptuar, për të bërë ndonjë deklaratë publike në emër të Palës tjetër, si dhe të gjitha komunikatat për shtyp në lidhje me këtë MM duhet të aprovohen paraprakisht me shkrim nga Palët para lëshimit të tyre.

NENI XI

Njoftimet

1. Çdo njoftim që kërkohet të bëhet nga cilado Palë në bazë të kësaj Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim dhe do të konsiderohet se është bërë kur të jetë pranuar nga Pala tjetër, në adresat e më poshtme:

Për UN-Habitat-in	Për PAX-in	Për Komunën e Vushtrrisë
<p><u>Për çështje operative:</u> Emri: Gwendoline Mennetrier Titulli: Krye-këshilltare teknike Adresa: Objekti qeveritar "Rilindja", kati 10 10000 Prishtinë, Kosovë Tel.: +381 38 200 32611 Email: gwendoline.mennetrier@unhabitat-kosovo.org</p>	<p><u>Për çështje operative:</u> Emri: Micahel James Warren Titulli: Menaxher i Programit Adresa: PO Box 19318, 3501 DH Utrecht, Holandë Tel.: + 31(0) 6 121 676 07 (NL) + 386 (0) 49 337 616 (KS) Email: warren@paxforpeace.nl</p>	<p><u>Për çështje operative:</u> Emri: Berat M.Sadiku Titulli: Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Adresa: Drejtorati per Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kati 1 Sheshi Hasan Prishtina, Komuna e Vushtrrisë Tel.: +383 45 941 555 Email: beratsadiku@gmail.com</p>

NENI XII

Natyra konfidenciale e dokumentave

1. Informacioni që konsiderohet në pronësi të secilës Palë dhe që shpërndahej ose i zbulohet dikujt tjetër, dhe që konsiderohet si konfidencial, duhet të mbahet në mirëbesim nga ajo Palë dhe duhet të përdoret për qëllimin për të cilin është zbuluar.

NENI XIII

E drejta e autorësisë, patentave dhe të drejtat tjera të regjistruara

1. Përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me shkrim në Marrëveshje, Palët gëzojnë të drejtën mbi tërë pronën intelektuale dhe të drejtat e tjera të regjistruara përfshirë, por duke mos u kufizuar në, patentat, të drejtën e autorësisë dhe markat tregtare, lidhur me produktet, proceset, shpikjet, idetë, njohuritë, ose dokumentet dhe materialet e tjera që ose janë në lidhje të drejtpërdrejtë me, ose janë prodhuar, përgatitur ose mbledhur si rrjedhojë, ose gjatë përmbushjes së Marrëveshjes.

Nëse një pronë e tillë intelektuale ose të drejtat e tjera të regjistruara përbëhen nga ndonjë e drejtë intelektuale ose të drejta tjera të regjistruara të cilësdo Palë: (i) që kanë ekzistuar para fillimit të punës së cilësdo Palë në përmbushjen e obligimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, ose (ii) që cilado Palë mund t'i zhvillojë ose sigurojë, ose ka mundur t'i zhvillojë ose t'i fitojë, pavarësisht punës në përmbushjen e obligimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, cilado Palë nuk pretendon dhe nuk do të pretendojë kurrfarë interesi pronësor mbi to, pa lejen paraprake me shkrim nga përfaqësuesi i autorizuar i Palës në cilindo rast.

NENI XIV

Dëmshpërblimi

1. Komuna e Vushtrrisë do të dëmshpërblejë, mbajë dhe ruajë të padëmtuar, dhe t'i mbrojnë me shpenzimet e tyre, UN-Habitat-in, zyrtarët e tyre, agjentët dhe punonjësit nga, dhe kundër të gjitha padive, procedurat, pretendimeve, kërkesave dhe detyrimeve të çfarëdo lloji, përfshirë kostot dhe shpenzimet e tyre, që dalin nga veprimet apo lëshimet e komunës së Vushtrrisë, ose nga punonjësit, zyrtarët, agjentët ose nën-kontraktuesit e komunës së Vushtrrisë, gjatë përmbushjes së këtij MM. Kjo dispozitë, mes tjerash, mbulon edhe pretendimet dhe detyrimet të natyrës së kompensimit të punëtorëve, detyrimet për produktin dhe detyrimet që krijohen si rezultat i shfrytëzimit të shpikjeve apo pajisjeve të patentuara, materialeve që mbrohen me të drejtën e autorit ose apo pronën intelektuale nga komuna e Vushtrrisë, punonjësve të tyre, zyrtarëve, agjentëve ose nën-kontraktuesve. Obligimet sipas këtij Neni nuk marrin fund me përfundimin e të këtij MM.

NENI XV

Zyrtarët që nuk duhet të përfitojnë

1. Komuna e Vushtrrisë garanton se nuk ka ofruar dhe nuk do të ofrojë asnjë përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që del nga ose në lidhje me zbatimin e këtij MM, ose ndonjë çmim për përfaqësuesit, zyrtarët, punonjësit ose agjentët tjetër të UN-Habitat-it. Palët pranojnë dhe pajtohen që çdo shkelje e kësaj dispozite është shkelje thelbësore e këtij Memorandumi.

NENI XVI

Konflikti i interesit

1. Palët garantojnë që në momentin e nënshkrimit të këtij Memorandumi nuk ka konflikt interesi ose nuk ka mundësi të paraqitet gjatë zbatimit të detyrimeve të tij sipas këtij MM.
2. Në qoftë se ka ose ka të ngjarë të ketë konflikt interesi gjatë kohëzgjatjes së këtij memorandumi, palët nënshkruese duhet:
 - (a) Menjëherë të njoftojnë njëra-tjetrën;
Të paraqesin në tërësi të gjitha informatat relevante në lidhje me konfliktin; dhe
 - (b) Të ndërmarrin hapa të tillë, siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme për të zgjidhur ose ndryshe të ballafaqohen me konfliktin.

NENI XVII

Statusi ligjor i Palëve

1. Asgjë në këtë ose në lidhje me këtë MM nuk interpretohet si bazë për krijimin e partneritetit, ndërmarrjes së përbashkët, punësimit apo relacioneve të agjencisë në mes Palëve.
2. Zyrtarët, përfaqësuesit, punonjësit, apo nën-kontraktorët e secilës Palë nuk do të konsiderohen në asnjë mënyrë si punonjës ose agjentë të Palës tjetër.
3. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve në bazë të këtij MM do të jetë në baza jo-ekskluzive.

NENI XVIII

Hyrja në fuqi

1. Ky MM hyn në fuqi pasi të nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve, dhe do të jetë efektiv nga data e nënshkrimit të fundit dhe do të jetë në fuqi për periudhën deri me 30 shtator 2020 nga hyrja në fuqi e këtij MM, përveç nëse ndërpritet më herët nga ndonjëra Palë në përputhje me Nenin VI ("Ndërprerja") më sipër.

NENI XIX

Dispozitat tjera




1. Ky MM është subjekt i shqyrtimit formal afatmesëm të progresit dhe ri-vlerësimit të zotimit komunal gjatë kohëzgjatjes së projektit.
 - (i) Nëse, si pjesë e këtij procesi, UN-Habitat-i dhe/ose PAX vërtetojnë se komuna:
 - a) ka dëshmuar të mos jetë angazhuar mjaftueshëm në zbatimin e planit/planeve të punës, apo
 - b) ka vepruar në kundërshtim me frymën e MM,

atëherë UN-Habitat-i dhe/ose PAX gëzon të drejtën të pezullojë punën në komunë. Pezullimi i tillë i konfirmohet me shkrim komunës nga UN-Habitat-i dhe/ose PAX. Rifillimi i punës së UN-Habitat-it dhe/ose PAX do të varej komuna në rast se ofron dëshmi të pranueshme ku sigurohen UN-Habitat-i dhe/ose PAX që çfarëdo e mete apo mangësi që kanë qar në pezullimin e punëve janë rregulluar apo përmirësuar.

NENI XX
Marrëveshja e plotë

1. Ky MM paraqet kuptimin e plotë të UN-Habitat-it, PAX-it dhe Komunës së Vushtrrisë sa i përket temës kryesore të tij dhe i zëvendëson të gjitha komunikimet me gojë dhe dokumentet paraprake me shkrim.

ME KËTË VËRTETOHET SE, të nënshkruarit më poshtë, përfaqësuesit e autorizuar të UN-Habitat-it, PAX-it dhe Komunës së Vushtrrisë, e kanë nënshkruar këtë MM në tri (3) kopje origjinale në vendin(et) dhe në datën(at) e shënuara më poshtë:

Për UN-Habitat-in	Për PAX-in	Për Komunën e Vushtrrisë
		
Gwendoline Mennetrier Krye-këshilltare Teknike	Michael James Warren Menaxher i Programit	Xhafer Sh/Tahiri, Kryetar
Vendi: <u>Vushtrri</u>	Vendi: <u>Utrecht</u>	Vendi: <u>Xh. Tahiri</u>
Data: <u>16/06/2018</u>	Data: <u>04-18-2018</u>	Data: <u>18/06/2018</u>

Shtojca A

Anëtarët e Ekipit Komunal për Planifikim për bashkëpunim me UN-Habitat-in

Komuna dhe UN-Habitat-i kanë emëruar personelin e dhënë më poshtë si anëtarë të Ekipit Komunal për Planifikim (EKP), duke përfshirë edhe pikat e kontaktit për komunikim të drejtpërdrejtë.

Emërimet për Ekipin Komunal për Planifikim

Nr.	Emri	Drejtoria Komunale
1	Berat Sadiku	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
2	Fortuna Krasniqi Spahiu	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
3	Ardi Ukshini	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
4	Ajet Gerxhaliu	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
5	Islam Latifi	Drejtoria për Shërbime Publike
6	Ramiz Maliqi	Drejtoria për Inspeksion
7	Naim Ferizi	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
8	Mexhit Perquku	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
9	Berat Januzi	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
10	Agim Miftari	Drejtoria për Arsim
11	Shukrane Begu	Muzeu Historik dhe Etnografik
12	Merita Rama Mulaku	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
13	Mustafa Xhoni	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
14	Remzije Zekolli	Koordinatorë për çështje gjinore
15	Liridon Lahu	Drejtoria për Administratë

Komuna cakton personelin në vijim në Këshillin Drejtues, të udhëhequr nga Kryetari i Komunës:

1. Xhafer Sh. Tahiri, Kryetar i Komunës
2. Berat Sadiku, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
3. Adnan Lahu, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë


UN-Habitat-i cakton personelin në vijim për përkrahje të Ekipit Komunal për Planifikim:

Besnike Kocani, Planere Urbane/Hapësinore

Arijeta Himaduna, Zyrtare për Ndërlidhje/Shoqëri civile dhe për Barazi Gjinore

Avni Alidema, Këshilltar për Qasje tek Qytetarët

Përveç kësaj, PAX / CBM cakton Lazar Rakic, Këshilltar Teknik, për të ofruar mbështetje për zhvillimin e Planit për Pjesëmarrje të Qytetarëve, veçanërisht nëpërmjet pikës personit kontaktues të caktuar nga Komuna, Blerim Zhabari, Zyrtar për Informim.



MEMORANDUM OF UNDERSTANDING

BETWEEN

THE UNITED NATIONS HUMAN SETTLEMENTS PROGRAMME

AND

PAX

AND

MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

PREAMBLE:

WHEREAS, the United Nations Human Settlements Programme (hereinafter referred to as "**UN-Habitat**"), established by the General Assembly of the United Nations by its resolution 32/162 of 19 December 1977, transformed into a Programme by its resolution 56/206 of 21 December 2001, having its Headquarters in Nairobi, Kenya. UN-Habitat is the coordinating agency within the United Nations System for human settlement activities, the focal point for the monitoring, evaluation and implementation of the Habitat Agenda, as well as the task manager of the human settlements chapter of Agenda 21, and, and, in collaboration with governments is responsible for promoting and consolidating collaboration with all partners, including local authorities and private and non-governmental organizations in the implementation of the Habitat Agenda and the Post-2015 Sustainable Development Goals (SDGs) in particular, Goal 11 of "*Making cities and human settlements inclusive, safe, resilient and sustainable*";

